


# TaxNews

Shkurt 2019  
February 2019



Në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 26.02.2019 është publikuar Udhëzimi nr. 4, datë 21.02.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 'Për tatimin mbi të ardhurat', i ndryshuar". Ky udhëzim ka reflektuar dhe zgjeruar ndryshimet e sjella nga Paketa Fiskale 2019 në Ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat" (të përmbledhura në serinë e publikimeve tona të njëpasnjëshme në shtator dhe dhjetor 2018), por gjithashtu ka paraqitur dhe disa ndryshime të tjera të cilat nuk kanë qenë pjesë e Paketës Fiskale 2019 duke përditësuar me shembuj apo sjellë trajtime të ndryshme.

### **Të ardhurat nga shërbimet e jo-rezidentëve me burim në Shqipëri**

Ndryshimet në nenin 4 të ligjit dhe në pikën 5.2 të udhëzimit konfirmojnë se të ardhurat nga shërbimet e kryera nga personat jo rezidentë për një person rezident do të konsiderohen me burim në Shqipëri, dhe pra të tatueshme në Shqipëri, përveçse nëse përjashtohen nga tatimi në Shqipëri sipas dispozitave të marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë që Shqipëria ka lidhur me vendin, rezident i së cilës është përfituesi i të ardhurave.

### **Të ardhurat nga pasuri të paluajtshme, minerale, hidrokarbure etj. me burim në Shqipëri**

Reflektohet zgjerimi i bazës së të ardhurave me burim në Republikën e Shqipërisë në vijim të ndryshimeve në nenin 4 të ligjit duke konsideruar si të ardhura me burim në Shqipëri edhe të ardhurat nga:

- a. të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale,
- b. të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure,

In the Official Gazette no. 23, dated 26.02.2019 is published the Instruction no. 4, dated 21.02.2019 "On some additions and amendments to the Instruction no. 5, dated 30.01.2006 "On income tax", as amended. This instruction has reflected and expanded the amendments introduced by the Fiscal Package 2019 to the Law "On income tax" (summarized in our series of successive publications in September and December 2018), but has also presented some additional amendments that were not part of the Fiscal Package 2019 by updating examples or bringing different treatments.

### **Income of non-residents for services sourced in Albania**

The amendments to the article 4 of the law and to the point 5.2 of the instruction confirm that income from services performed by non-resident persons for a resident person shall be considered as sourced in Albania and therefore taxable in Albania, unless exempt from taxation in Albania under the provisions of the double tax treaties that Albania has concluded with the country in which the recipient of the income is resident.

### **Income from immovable property, minerals, hydrocarbons etc. sourced in Albania**

Expansion of the income tax basis sourced in the Republic of Albania has been reflected, following the amendments to the article 4 of the law, considering as income sourced in Albania also income from:

- a. rights for exploitation of mineral resources,
- b. rights for exploitation of hydrocarbon resources,

- c. fitimet nga shitja e aksioneve (ose interesave të ngjashëm) vlera e të cilëve rrjedh në më shumë se 50% nga pasuria, të drejtat ose informacionet në lidhje me to në Republikën e Shqipërisë,
- d. të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- e. informacioni që u përket këtyre të drejtave.

Në udhëzim sqarohen më gjerë konceptet e të drejtave për shfrytëzimin e pasurive minerale dhe hidrokarbure, si dhe koncepti i informacioneve të lidhura me këto të drejta.

### Tatimi mbi dividendët dhe fitimet e ortakëve

Reflektohet në udhëzim reduktimi i normës së tatimit mbi dividendët që u shpërndahen aksionarëve e mbi fitimet që u shpërndahen ortakëve nga 15% në 8%.

### Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme

Zgjerohet koncepti i kalimit të të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesë, truall, dhe tokë bujqësore) duke përfshirë përveç aktit të shitjes dhe dhurimit, edhe heqjen dorë nga pasuria e paluajtshme.

Prezantohet për herë të parë në udhëzim koncepti i "fitimit kapital të realizuar". Më parë, koncepti i fitimit kapital të realizuar sqarohet shkurtimisht vetëm në Udhëzuesin për Plotësimin e Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA). Sipas udhëzimit me termin "fitim kapital i realizuar" nënkuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme tokë dhe/ose ndërtesë.

- c. gains from the sale of shares (or similar interests) deriving their value in more than 50% from the property, rights or information related to them in the Republic of Albania,
- d. other rights for exploitation of natural onshore and offshore resources, including seas in the Republic of Albania, as well as
- e. information that pertains to these rights.

The instruction further clarifies the concept of the rights for exploitation of mineral and hydrocarbon resources, as well as the concept of the information related to such rights.

### Tax on dividends and profit share

It has been reflected in the instruction the reduction of the withholding tax on dividends and profits distributed to shareholders from 15% to 8%.

### Transfer of ownership rights on immovable properties

The instruction expands the concept of the transfer of ownership rights on immovable properties (building, land, and agricultural land) by including also the waiver of ownership rights on immovable properties besides sales and donations.

For the first time, the instruction introduces the concept of the "realized capital gains". Previously, the concept of the realized capital gains was briefly clarified in the Instructions for the Filing of Annual Declaration of Personal Income (DIVA). According to the instruction, "realized capital gains" refers to the positive difference between the selling value and the purchase value of the immovable property land and/or building.

Në rastet e dhurimit apo heqjes dorë, vlera e pasurisë së paluajtshme përcaktohet sipas Udhëzimit të përbashkët nr. 29, datë 20.07.2018 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme".

Reflektohen gjithashtu në udhëzim, në listën e të ardhurave të përjashtuara për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale edhe rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Per tokën", i ndryshuar (ndryshim ky i prezantuar në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat nëpërmjet ligjit nr. 39/2018, në shtator 2018 – për lehtësinë tuaj referojuni Tax News tonë të muajit shtator 2018).

### **Personat jo-rezidentë subjekte të tatimit mbi fitimin**

Personat jorezidentë që nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme, të drejtat mbi to apo nga tjetërsimi i tyre, do të jenë subjekt i tatimit mbi fitimin. Këta persona jo-rezidentë i nënshtrohen tatimit mbi fitimin që rezulton nga shitja e aksioneve në qoftë se, në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 përqind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme e ndodhur në Shqipëri, të drejtat ose informacioni i lidhur me të.

In cases of donation of or waiver of the immovable property, the value of the immovable property is determined in accordance with the joint Instruction no. 29, dated 20.07.2018 "On taxation of the transfer of the right of ownership over the immovable property".

In the list of income exempt from personal income tax, the instruction reflects also for the cases of transfer of the ownership rights of ownership within the family between men, women, children, through donation and/or ownership waiver, when the property derives from compulsory joint ownership acquired under Law 7501, dated 19.07.1991 "On land", as amended (*this amendment was introduced in the Law on Income Tax through law no. 39/2018 in September 2018 – please refer to our Tax News of September 2018*).

### **Non-resident persons subject to corporate income tax**

Non-resident persons that are not subject to income tax from the rights over the immovable properties, the rights over the immovable property or their alienation, shall be subject to corporate income tax. These non-resident persons are subject to the income tax resulting from the sale of shares if, at any time during the 365 days period before the alienation, more than 50% of the value of these shares derives directly or indirectly from the immovable property located in Albania, or from the rights or information related to such immovable property.

Jo-rezidenti nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin nëse ky jo-rezident është subjekt i tatimit mbi të ardhurat si më sipër. Detyrimi i vetëm për tatimin e jo-rezidentëve si për tatimin mbi të ardhurat ose për tatim fitimin lidhet me faktin që burimi i të ardhurave duhet të jetë në Shqipëri.

### Shpenzimet e panjohura

Reflektohet në udhëzimin e tatimit mbi të ardhurat, nën paragrafin 3.6 "Shpenzimet e panjohura" shpenzimet për dietat e punonjësve që tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore. Ndryshim ky i cili ka për qëllim të kufizojë mënyrat për shmangien e tatimeve mbi pagën.

Reflektohen gjithashtu në shpenzime të panjohura, teprica e shpenzimit të interesit neto që tejkalon 30% të EBITDA të shoqërisë huamarrëse në rastet e kredive, huamarrjes apo financimeve nga persona të lidhur. Në udhëzim sqarohet koncepti i "tepricës së shpenzimit të interesit neto" dhe modalitetet e zbatimit të këtij kufizimi nëpërmjet disa shembujve.

Gjithashtu, theksohet se në rastet e kredive, huamarrjes ose financimeve nga persona jo të lidhur, do të zbatohen kufizimet e pikës g) të paragrafit 3.6.

### Shpenzimet e amortizimit

Llogaritja e amortizimit ndërpritet për të gjitha aktivet afatgjata që nuk marrin pjesë në veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit, përfshirë rastet kur aktivi afatgjatë nuk është në përdorim apo del jashtë veprimtarisë.

The non-resident is not subject to the corporate income tax if the non-resident is subject to the income tax as stated herein above. The only obligation for the taxation of non-residents for personal income tax or corporate income tax is related to the fact the source of income must be in Albania.

### Non-deductible expenses

Paragraph 3.6 "Nondeductible expenses" reflects the amendment regarding the expenses per diems of employees that exceed 50% of the annual gross salary fund. Such amendment aims to limit the methods for the avoidance of taxes on salaries.

The amending instruction also reflect the changes regarding the surplus of the net interest expense that exceeds 30% of the EBITDA of the borrowing company in cases of loans, borrowings or financing from related parties. In the amending instruction are clarified the concepts of "surplus of net interest expense" and the methods of application of such limitation through some examples.

Additionally, the instruction states that in cases of loans, borrowings or financings from unrelated parties, the limitations set in letter g) of paragraph 3.6 shall be applicable.

### Depreciation expenses

The calculation of depreciation is terminated for all long term assets that do not contribute in the economic activity of the taxpayer, including the cases where the long term assets is not in use or is not used for purposes of the main activity.

### **Fshirja e borxhit të keq për bankat**

Reflektohet tanimë parashikimi në lidhje me trajtimin e shpenzimeve të borxhit të keq në rastet kur kolaterali ekzekutohet përpara se të përmbushet afati 365 ditor i parashikuar në ligj në rastin e kredive të siguruara me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme. Sipas udhëzimit, nëse pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë ekzekutohet para afatit 365 ditë të përcaktuar në pikën i) të ligjit, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të njohura do të vazhdojnë të konsiderohen si të tilla.

### **Ndryshimi i pronësisë dhe penalitetet për mos njoftimin e tij**

Shtohet një paragraf i veçantë në udhëzimin për tatimin mbi të ardhurat në lidhje me ndryshimin e pronësisë, ku sqarohet qëllimi i kësaj dispozite, modalitetet e zbatimit nëpërmjet disa shembujve dhe detyrimet për njoftim. Qëllimi i këtij paragrafi është të bëjë të mundur që fitimet nga shitjet/transferimet indirekte të aktiveve të vlefshme në Shqipëri të jenë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri.

Vlen të theksohet se në udhëzim nënvizohet se detyrimi për njoftim nuk zbatohet në rast se shitja e aksioneve rezulton në më pak se 10% ndryshim pronësie në shoqërinë shqiptare pasi në këtë nivel, shoqëria shqiptare mund të mos jetë në dijeni të transaksionit të shitjes.

Megjithatë, edhe pse nuk ka detyrimin për njoftim, shitja e aksioneve mbetet e tatueshme në Shqipëri me kusht që aksionet të marrin më shumë se 50% të vlerës së tyre nga pasuria e paluajtshme në Shqipëri.

### **Bad debt write-off for banks**

The instruction now reflects a provision regarding the treatment of bad debt expenses in the cases where the collateral is executed before the end of the 365 days deadline set by the law in cases of loans secured with movable or immovable properties. According to the amending instruction, if the movable or immovable property that secures the loan is executed before the 365 days deadline set in letter i) of the law, the previous bank provisions considered as deductible expenses shall continue to be considered as such.

### **Change of ownership and penalties for failure to notify**

A special paragraph is added in the instruction on income tax regarding the change of ownership thereby clarifying the purpose of such provision, modalities of application through some examples and notification requirements. The purpose of this paragraph is to enable taxation in Albania of gains from the indirect sale/transfer of valuable assets in Albania.

It is important to emphasize that the instruction clarifies that the notification requirement is not applicable in the cases where the sale of shares results in a change of less than 10% in the ownership of the Albanian companies because at such level, the Albanian company may not be aware of the sale transaction.

However, even though there is no obligation for notification, the sale of shares is still taxable in Albania under the condition that more than 50% of the value of the shares derives from the immovable property in Albania.

### **Deklarimi dhe pagesa e tatimit mbi fitimin nga persona jo-rezidentë**

Në udhëzimin ndryshues rikonfirmohet detyrimi për personat jo-rezidentë që përfitojnë të ardhura me burim në Shqipëri të cilët janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri për të dorëzuar një formular të posaçëm: "Formularin e Deklarimit dhe Pagesës nga persona jo-rezidentë specifike" forma e të cilit është publikuar në këtë udhëzim.

### **Kreditimi i tatimit të huaj dhe kreditimi i humbjeve**

Në udhëzimin ndryshues janë përditësuar shembujt në lidhje me kreditimin e tatimit të huaj dhe kreditimin e humbjeve jashtë vendit, por pa sjellë ndryshime në trajtimin e tyre.

### **Declaration and payment of corporate income tax from non-resident persons**

The amending instruction reconfirms the obligation for non-resident persons earning an income sourced in Albania that are subject of corporate income tax in Albania to submit a special form: "Form of Declaration and Payment by non-resident persons", the form of which is enclosed to this instruction.

### **Credit of foreign tax and credit of losses**

The amending instruction updates the examples around crediting the foreign tax and losses outside Albania but without bringing changes in their treatment.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services

Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit

Gjeologji Miniera

Tirana | Albania

Mob: +355 68 60 33 116

E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.